

PREZANTIM LIBRI

KEQFORMIMET E BASHKËLINDURA NË NEONATOLOGJI



DR.SHK.MJ. FAIK BARDHI
SHEF I SHËRBIMIT TË NEONATOLOGJISË
SPITALI KRUJË, SHQIPËRI

Në promovimin e librit të Dr.Shk.Mj. Faik Bardhi, “**KEQFORMIMET E BASHKËLINDURA NË NEONATOLOGJI**”, që u organizua në një nga ambientet e Kalasë së Krujës, morën pjesë me diskutimet e tyre: recensuesi e librit Dr. Haki Cerhozi – pediatër në spitalin Krujë, Dr. Edi Tushe– shefi shërbimit të neonatologjisë shqiptare, Dr. Hysen Heta – shefi kirurgjisë infantile pranë spitalit pediatrik QSUT, Dr. Bajam Dallaku – mjek i spitalit Krujë, Dr. Muharrem Ferhati – mjek i spitalit Krujë.

Në këtë aktivitet ishin të pranishëm me pjesëmarrjen e tyre: mjekë të spitalit të Krujës, Ish mjekë të spitalit të Krujës, mjekë pensionistë, që kanë punar në këtë spital, mjekë nga shërbimi i neonatologjisë: të maternitetit “Mbretëresha Geraldinë”, të maternitetit “Koço Gliozheni”, të spitalit “Hygea”, Tiranë, mjekë dhe dashamirës nga rrethet e ndryshme të vendit.



Dr. Faik Bardhi. Këtij studimi monografik, i cili përmban një periudhë 30 vjeçare, i kam dhënë një pjesë jo të vogël nga puna dhe jeta ime.

Gjatë kohës që isha në specializim për neonatolog, në maternitetin e Tiranës dhe, qysh në fillim të punës, me hapjen e shërbimit të Neonatologjisë, në janar të vitit 1982, më bëri përshtypje lindja e fëmijëve me keqformime të ndryshme. Për këtë arsye fillova t'i mbledh dhe t'i studioj këto raste duke bërë një studim 5 vjeçar (1982 – 1987), duke vënë në dukje shkaqet e lindjes së fëmijës me anomali, mundësinë e përsëritjes së AK, mundësinë e korigjimit sa më të shpejtë pas lindjes të keqformimeve të ndryshme, ndjekjen e këtyre fëmijëve etj.

Duke e marrë tashmë si pasion ndjekjen dhe trajtimin e fëmijëve me AK e vazhdova më tej këtë punë duke e kompletuar çdo fëmijë që paraqet rast të veçantë me fotografi (të cilat janë bardhë e zi dhe me ngjyra). Kam ndjekur ecurinë e disa fëmijëve edhe pas operacionit edhe në mosha të mëdha, sipas rastit kur na është dhënë mundësia e komunikimit me prindërit dhe fëmijën, tashmë të rritur. Këto raste janë dokumentuar me foto të krahasueshme.

Gjatë këtyre viteve, herë pas here, kam paraqitur studime mbi AK; në konferenca kombëtare të pediatrikë dhe të obstetrikë-gjinekologjisë, në sesionet shkencore të rrethit, si dhe kam botuar në revistat kombëtare etj. Por përmbledhja në këtë monografi është një ndër studimet më me vlerë, duke e konsideruar si manual në duart e mjekëve në përgjithësi dhe të pediatërve e neonatologëve në veçanti.

Në këtë punim kam ndërthurur anën teorike me atë praktike, kam ndarë anomalitë sipas sistemit që kanë prekur, duke i paraqitur me foto dhe me shifra statistikore, duke e bërë librin më të kapshëm për lexuesin, si dhe një studim me vlera shkencore.

Dr. Haki Cerhozi: në diskutimin e tij theksoi:

Ndjehem i nderuar që më jepet mundësia të flas para jush për monografinë e Dr. Faikut.

Që në fillimet e karrierës profesionale dr. Faiku hyri me plot dëshirë, pasion e nisma të guximshme në shërbimin mjekësor të rrethit të Krujës. Kështu, ai u përfshi vrullshëm në rrethin e atyre mjekëve që kishin ndezur flakën e studimeve shkencore dhe futjen e së resë bashkëkohore në diagnostikimin dhe trajtimin e sëmundjeve. Këtë flakë, në kohët e sotme, e mban lart dr. Faiku. Kjo kërkon dëshirë, pasion dhe këllqë për shkencën, cilësi për të cilat dr. Faiku është i shquar.

Qysh atëherë e gjer më sot dr. Faiku nuk reshti së studiuar dhe botoi varg e vister studime, kumtesa dhe libra. Në vitet e vështira 1996-1997 mbrojti me sukses disertacionin **“Peshat e vogla në lindje dhe rëndësia e tyre në vdekshmërinë rreth lindjes dhe në atë foshnjore të hershme të qytetit të Krujës.” duke fituar gradën “Doktor i Shkencave”.**

Fakt i kësaj vazhdimësie është ky libër që kemi në dorë sot, i cili shënon një nga kulmet e studimeve të kryera në Krujë dhe më gjërë, lule e bukur plot erëzim që do të zërë vend në tubën e luleve të shkencës mjekësore shqiptare.

Libri është shkruar me saktësi shkencore, me dashuri dhe me shqipe të pastër, të qartë, të kuptueshme dhe i këndshëm në lexim.

Libri ndahet në dy pjesë kryesore. Pjesa e parë me frymë akademike dhe pjesa e dytë me synim utilitar. Në pjesën e parë të librit, pa rënë në akademizëm, diskuton shkallën e lartë të njohurive të sotme që paraqesin keqformimet e lindura. I spikatur është përshkrimi i dijeve bashkëkohore për njohjen e hershme dhe shumë të hershme të tyre.

Në pjesën e dytë të librit shpaloset përvoja e gjatë 30 vjeçare (1982-2011) mbi 19.717 lindje të gjalla, me 439 fëmijë të lindur me keqformime të diagnostikuara dhe trajtuara nga dr. Faiku në maternitetin e Krujës. Për dr. Faikun njohja në brendësi e anomalive ka qenë shqetësim immanent që e ka ndjekur gjatë gjithë karrierës së tij mjekësore.

Shumica e rasteve ilustrohen edhe me fotografi në lindje dhe në ecurinë e tyre pas trajtimit të bërë. Këto i bëjnë keqformimet e rasteve vetjake më të qarta dhe të nxisin për ta lexuar librin. Nga diskutimi i materialit të bollshëm qartësohet se këshillimi gjenetik është parandalimi më efikas i lindjeve me keqformim.

E vlerët është edhe përimtimi i përlogaritjeve. Vërtetësia e shifrave në vlera absolute dhe relative përforcohet nga mbikqyerja me anën e metodave të sotme të saktësisë; testit të Studentit, Hi Katrorit dhe Indeksit të Standartizimit. Metodë të cilën autori, për herë të parë në vendin tonë, e fut gjërësisht në përpunimin statistikor të shifrave.

Vetvetishëm del se libri “Keqformimet e Bashkëlindura në Neonatologji” përuddh punën për njohjen e problemeve të keqformimeve. Ndërsa për neonatologët është arrirë synimi për të qenë vademekum në studimin dhe ngritjen e nivelit të dijeve shkencore mbi konceptimin e shtatzënive me keqformim dhe shmangien e tyre.

Libri quq dhe një tokiçë të dukurive të sotme të kritikueshme, mosvlerësimi i të cilave çon në rrugë të gëmtë mjekun dhe shërbimin mjekësor. Puna e mjekut është e pa kuptimtë pa studim të pandërprerë. Pa këtë strumbullar të punës së tij suksesi është i pa arrirë.

Në libër janë vënë në ajar ana mjekësore dhe ajo shoqërore që paraqet shtatzënia dhe fëmija me keqformim.

Së pari, është ana mjekësore. Parandalimi i lindjeve me keqformim në ditët e sotme është kyçi i zgjidhjes së problemit. Dr. Faiku i jep vendin e duhur ndihmesës që japin aparaturat dhe analizat laboratorike bashkëkohore.

Ata e kanë lartësuar dhe lehtësuar punën e specialistit të mjekësisë. Prandaj zotërimi dhe përdorimi i tyre në praktikën e përditshme është kusht *sine qua non*. Por kjo nuk do të thotë se duhet të huajsuar dhe të lëmë pas dore njohjen e shenjave dhe të shfaqjeve klinike të keqformimeve. Pasi është mjeku, ai, që përcakton shënjestrën e punës, të analizave dhe aparaturave.

Së dyti, është ana shoqërore. Lindja me keqformim është goditje për çiftin, familjen dhe shoqërinë. Këto jo rrallë shkaktojnë edhe stepje të çiftit për lindje të tjera. Pra ndikojnë drejtpërdrejtë në pakësimin e lindshmërisë dhe plakjen e popullatës, dukuri që kohët e fundit ka mësyer vullshëm shoqërinë shqiptare.

Vetëm një mjek i dijshtëm mund t`i diskutojë delikatisht me prindërit të gjitha problemet e lindjeve me fëmijë të keqformuar.

Tashmë Dr. Faiku ka zërin e tij në neonatologji dhe në shkencën mjekësore shqiptare, në fushën e keqformimeve të lindura.

Dr. Edi Tushe diskutimin e tij e përqëndroi në vlerat e librit dhe rëndësinë e studimit. Ai theksoi: Kjo është vërtetë një ditë e shënuar për Neonatologjinë shqiptare, aq më tepër kur mendon se bëhet fjalë për një aspekt shumë të rëndësishëm të sëmundshmërisë neonatale, që janë pikërisht keqformimet e lindura.

Neonatologjia shqiptare është ende e porsalindur, sapo ka filluar të lëviz, e të eci, nëpër shinat e rrugës së vet.

Prandaj duhet ta them me forcë dhe krenari njëkohësisht se libri i dr. Faikut, është ndër të parët në Shqipëri, që flitet për anomalitë kongjenitale, në vazhden e disa librave apo, atyre pak librave të botuara në Neonatologji. Natyrisht ky është një aspekt i së ardhmes; qoftë në drejtim të trajtimit, qoftë edhe të njohjes, të frekuencës e prezencës si problem i këtyre sëmundjeve që janë serioze e problematike gjithandej.

Ne duhet të ballafaqohemi gjithmonë me aspektin klinik, sepse, siç e dimë, ne mbështetemi, në shumicën e rasteve në aspektin klinik, pasi jemi të vetëdijshëm, se mundësitë laboratorike janë shumë të pakta për vendosjen e hershme të diagnozës së anomalive kongjenitale, është shumë e vështirë dhe kërkon këshillime të shumëllojshme. Njëkohësisht, në kushtet e një vendi si i yni që ka pak mundësi për të bërë diagnozë biologjike, gjenetike të sëmundjeve të tilla, Është e vështirë, edhe për ne, prandaj duhet të bëhet vlerësimi klinik që është shumë e shumë i rëndësishëm.

Një nga aspektet e rëndësishme nuk është vetëm vënia e diagnozës, por edhe ballafaqimi me prindërit. Ky është një ballafaqim shumë delikat, sepse në një vend të vogël si Shqipëria shpesh herë kemi të bëjmë me njerëz të njohur. Secili prej nesh ka një motër, një komshi, ka një shok, apo shoqe, ka mundësi që për dikë, të marrë pjesë në lindje.

Akoma nuk mund të kuptojmë se sa i rëndë dhe i vështirë është momenti i ballafaqimit me prindërit dhe familjen, kur dhe ku duhet t'i themi një "lajm të keq", siç është ky.

Në shumë aspekte ky libër mund të quhet themel i rëndësishëm për këdo që merr pjesë në lindje ose që ballafaqohet me problemin e një fëmije të lindur me të "meta"

Unë s'kam çfarë të them tjetër për aspektin e rëndësisë që ka ky libër për vendin tonë, e më gjërë Ajo që mund të them me siguri, jo vetëm si shok, por edhe si kolegë, është kontributi i rëndësishëm që jep ky libër, jo vetëm për neonatologjinë ose për neonatologët, por edhe për mjekët e familjes dhe, për këdo që duhet të ballafaqohet me një ngjarje të tillë.

Dr. Hysen Heta: në diskutimin e tij theksoi se një rol të rëndësishëm në zhvillimin e mjekësisë shqiptare ka bashkëpunimi i të gjitha strukturave të shëndetësisë, të çdo niveli.

Prej vitesh ne merremi me këtë kontigjent, fëmijësh, të cilët, i kemi konsideruar të pajetueshëm dhe të pamjekueshëm. Që të merresh me to duhet patjetër të kesh informacion. Libri i dr. Faikut e jep këtë lloj kënaqësie. Pra jep informacion të gjërë e të thellë shkencor.

Kënaqësia është, sepse në botimet shqiptare nuk kemi shumë të dhëna mbi anomalitë e lindura.

Unë prej vitesh bashkë me bashkëpunorët e mi merren me anomalitë dhe, vërtetë, duke shfletuar librin ndjeva dhe gjeta kënaqësi, sepse u njoha me një pjesë të mirë të anomalive që edhe vetë i kemi kaluar në punën tonë të përditshme.

Pjesa jonë e mjekësisë është t'i diagnostikojmë në kohë dhe të përfitojmë sa më shumë nga ky kontigjent.

Gjithë bota mjekësore këtë kërkon, sepse me një investim, këto fëmijë rriten mirë në familjet e tyre, në kushtet që kanë.

Mjekët, krahas asaj që studiojnë në bankat e shkollës, kanë mundësi të gjejnë nëpërmjet këtij libri shumë anomali të trajtuara e të studjuara nga autori prej vitesh.

Kështu që libri i dr. Faikut e ka plotësuar këtë boshllëk, të madh, mangësinë që ka patur shkolla jonë dhe bibliotekat tona.

Është bërë një punë kolosale e me durim. Që të merresh për një kohë kaq të gjatë dhe rast pas rasti, mendoj se është një përgjegjësi e madhe dhe fakt tepër pozitiv, Ndaj duhet të ndalemi dhe ta vlerësojmë për rëndësinë dhe vlerat që ka.

Dr. Bajam Dallaku: në fjalën e tij e vuri theksin në rëndësinë që ka studimi, jo vetëm për spitalin e Krujës, por edhe në nivel kombëtar e më gjërë.

Është kënaqësi të thuash dy fjalë, në të tilla raste, kur puna shumëvjeçare e një kolegu kurorëzohet me një botim të tillë, si ky që po prezantohet sot, i dr. Faikut.

Domosdo do të arrihej në të tilla përfundime, pasi dr. Faiku që në fillimet e punës, hapi shërbimin e neonatologjisë në rrethin e Krujës, me dëshirën e mirë dhe pasionin që e karakterizon, për ta çuar përpara këtë shërbim

Rastet me anomali në përgjithësi janë ndjekur për një kohë të gjatë siç është rasti me labiokingivopalatoovuloskizis bilateral i ndjekur deri në shërim të plotë në moshën 27 vjeçare. Kështu janë ndjekur edhe rastet me kardiopati, rastet me atrezitë ezofagut të operuar në kirurgjinë infantile, ku edhe bashkëpunimi me këtë shërbim ka qenë i vazhdueshëm dhe shumë i suksesshëm. Së fundi, mendoj se ky libër është një mesazh për mjekët e sidomos mjekët e rinj, që shkenca nuk bëhet vetëm në katedrat apo spitalet universitare, por kudo ku punohet.

Cilido në punën e tij të përditshme ndeshet me raste të veçanta që duhen vlerësuar, por që kërkojnë vëmendje dhe përkushtim për t'i mbledhur dhe pasqyruar ato.

Dr. Muharrem Ferhati: Dr Faiku ka bërë disa studime me vlera, por veçanërisht, ky libër, të cilin e kam lexuar me kujdes, më ka pëlqyer shumë. Është mjaft i saktë, mjaft konciz, ka vlera jo vetëm për mjekët në fushën e pediatriisë dhe neonatologjisë, por edhe për mjekët e familjes, mjekët në maternitete, është mjaft i vlefshëm për të gjithë punonjësit në fushën e shëndetësisë e më gjërë.

Për dr. Faikun mund të flasësh shumë, sepse ka vlera, është një nga 2-3 mjekët e qytetit që qëndron në krye, në lartësinë e duhur për punën studimore dhe shkencore.

Gjithashtu nga të pranishmit pati komente pozitive rreth punës këmbëngulëse të dr. Faik Bardhit për realizimin e këtij botimi, i pari në zhanrin e tij në Shqipëri.

Libri për nga përmbajtja e tij, jo vetëm në aspektin shkencor, por edhe në atë social, paraqet rëndësi të veçantë. Kjo për arsye se libri është trajtuar në mënyrë të atillë, që gjatë leximit të krijon një ndjesi që nuk e largon nga dora pa e shfletuar të gjithin. Gjithashtu, libri është i domosdoshëm jo

vetëm për punonjësit e shëndetësisë të niveleve të ndryshme, por edhe për lexuesin e thjeshtë. Kjo për arsyen e thjeshtë se lexuesi gjen në të përgjigje për shumë pyetje rreth shkaqeve të lindjes së keqformimeve të ndryshme dhe trajtimit të tyre të kohën e duhur.

Me një fjalë ky libër është një barrikadë e pesimizmit që lind te prindërit dhe të afërmit kur përballen me prezencën e një anomalie kongjenitale, sado e rëndësishme të jetë ajo për jetën e fëmijës dhe menjëherë kërkojnë rrugët për mundësinë e trajtimit dhe shërimit të kësaj anomalie.

Së fundi duke uruar dr. Faikun për librin e tij, të shkruar me shumë kompetencë dhe dashuri profesionale, shumë urime dhe suksese të tjera pastë në punë dhe në jetë!